- **Materialet:** Strukturë metalike për mbajtjen e formës së palloit dhe bishtit të tij, me përdorim të dritave LED dhe/ose fibrave optike për ndriçim.
- **Përmasat:** Dekorimi duhet të jetë i madhësisë së konsiderueshme një diametër rreth 1.5-2 metra, që të jetë i dukshëm dhe mbresëlënës në mjediset e hapura.
- **Ndriçimi:** Drita LED me ngjyra të ndryshme për të krijuar efekt të ndritshëm dhe festiv. Efekti i ndriçimit duhet të jetë i kombinuar për të krijuar kontrast të qartë dhe tërheqës.
- **Rezistenca ndaj kushteve të jashtme:** Dekorimi duhet të jetë i përshtatshëm për instalim të jashtëm dhe të jetë rezistent ndaj kushteve atmosferikë.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë vendosjen në punë dhe funksionalitetin e produktit, sipas termave të mësipërm.

15. Strukturë ndriçuese për foto

Koncepti i dizajnit grafik dhe pregatitja për strukturën ndriçuese që do shërbeje për fotografim të vizitoreve, në zonën e kopshtit zoologjik:

Përshkrimi i Konceptit të Dizajnit:

- **Tematika konceptuale:** Dizajni duhet të përshtatet me temën e eventit, që duhet të jetë festive. Dizenjatori duhet të zgjedhë ngjyrat dhe format e dritave në përputhje me atmosferën festive që dëshiron të krijojë. Dizajni duhet të jetë vizualisht tërheqës dhe festiv, veçanërisht gjatë natës.
- **Elementët Vizualë:** Dritat duhet të krijojnë një efekt tërheqës dhe mbreslënës, duke përdorur ngjyra të ndritshme dhe kombinime të ndryshme për të dhënë ndjesinë të një udhëtimi magjik nëpër kopshtin zoologjik. Dizenjatori duhet të vendosë kombinime të ndryshme të ngjyrave për të krijuar efekte dinamike, magjike të ngrohta dhe tërheqëse për vizitorët.
- **Efekte Magjike dhe Festive:** Dizajni duhet të krijojë një përvojë të këndshme dhe mbreslënëse për vizitorët, me drita që i shoqërojnë ata nga njëra anë në tjetrën. Vendosja e këndit fotografik duhet të jetë e tillë që të krijojë ndjesinë e një udhëtimi përmes një ambienti të magjishëm dhe të ndriçuar.
- **Kërkesë për dizenjime paraprake:** Përpara prodhimit, kërkohet paraqitja e disa dizenjimeve konceptuale që të pasqyrojnë ide të ndryshme të përputhshme me natyrën e kopshtit zoologjik. Këto dizenjime do të diskutohen dhe dakordësohen me autoritetin kontraktor për të arritur një dakordësi mbi dizajnin përfundimtar përpara se të fillojë ndërtimi/prodhimi.
- **Pregatitja për prodhim:** Dizajnet e përshkruara më lart duhet të pregatiten për prodhim sipas nevojave apo kërkesave të AK-së.

Specifikimet dhe kërkesat teknike:

- **Materialet e nevojshme:** Korniza (kornizë metalike ose alternativë e qëndrueshme). Mbulimi i jashtëm për reflektimin dhe shpërndarjen e dritave (materiale plastike, PVC, ose të tjera të përshtatshme).
- **Sistemi i ndriçimit:** Lloji dhe fuqia e dritave LED (me ngjyra të ngrohta). Sistemi i furnizimit me energji dhe menaxhimi i kablllove.
- **Dimensionet:** Përmasat e strukturës për t'u përshtatur për një fotobooth me përmasat e përafërta 100x180 cm
- **Stabiliteti:** Zgjidhjet për sigurinë dhe stabilitetin e strukturës, si për përdorim të brendshëm, ashtu edhe të jashtëm.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë vendosjen në punë dhe funksionalitetin e produktit, sipas termave të mësipërm.

16. Strukturë me gërma 3D "ZOO"

Koncepti i dizajnit grafik dhe pregatitja për strukturën ndriçuese, në zonën e kopshtit zoologjik:

Përshkrimi i Konceptit të Dizajnit:

- **Tematika konceptuale:** Dizajni duhet të përshtatet me temën e eventit, që duhet të jetë festive. Dizenjatori duhet të zgjedhë ngjyrat dhe format e dritave në përputhje me atmosferën festive që dëshiron të krijojë. Dizajni duhet të jetë vizualisht tërheqës dhe festiv, veçanërisht gjatë natës. Dizajni duhet të përmbajë shkrimi “ZOO” dhe në brendësi të tij të ketë imazhe/silueta kafshësh.
- **Elementët Vizualë:** Dritat duhet të krijojnë një efekt tërheqës dhe mbresëlënës, duke përdorur ngjyra të ndritshme dhe kombinime të ndryshme për të dhënë identitetin dhe personifikimin e ZOO-së. Dizenjatori duhet të vendosë kombinime të ndryshme të ngjyrave për të krijuar efekte dinamike, magjike të ngrohta dhe tërheqëse për vizitorët.
- **Efekte Magjike, Festive dhe identifikuese:** Dizajni duhet të krijojë një përvojë të këndshme dhe mbresëlënëse për vizitorët, me drita që i shoqërojnë ata nga njëra anë në tjetrën. Vendosja e tij duhet të jetë pozicionuar në një vend shumë të dukshëm.
- **Kërkesë për dizenjime paraprake:** Përpara prodhimit, kërkohet paraqitja e disa dizenjimeve konceptuale që të pasqyrojnë ide të ndryshme të përputhshme me natyrën e kopshtit zoologjik. Këto dizenjime do të diskutohen dhe dakordësohen me autoritetin kontraktor për të arritur një dakordësi mbi dizajnin përfundimtar përpara se të fillojë ndërtimi/prodhimi.
- **Pregatitja për prodhim:** Dizajnet e përshkruara më lart duhet të pregatiten për prodhim sipas nevojave apo kërkesave të AK-së.

Specifikimet dhe kërkesat teknike:

- **Materiali:** Korniza dhe pjesët e jashtme, me etalbond ose material të ngjashëm që siguron qëndrueshmëri dhe rezistencë ndaj kushteve atmosferike. Plexiglas transparent ose me ngjyrë për pjesët e brendshme të shkronjave, duke lejuar shpërndarjen e ndriçimit LED. Stukturë hekuri e cila do shërbejë si konstruksioni në të cilën do mbështetet ky instalacion.
- **Përmasat:** Afërsisht 100-150 cm i lartë, gjerësia totale e shkrimit afërsisht deri 300 cm dhe thellësia e shkronjave, sa të jetë e përshtatshme për të mbështetur sistemin e ndriçimit dhe për të dhënë një pamje të fortë vizuale.
- **Ndriçimi: LED të brendshëm:** Vendosje brenda shkronjave me plexiglas për ndriçim të barabartë dhe tërheqës gjatë natës.

17. Shkrim i stilizuar “OHoho”

Koncepti i dizajnit grafik dhe pregatitja për strukturën “Ohoho” jo-ndriçuese, në zonën e kopshtit zoologjik:

Përshkrimi i Konceptit të Dizajnit:

- **Tematika konceptuale:** Dizajni duhet të përshtatet me temën e eventit, që duhet të jetë festive. Dizenjatori duhet të zgjedhë ngjyrat dhe format e dritave në përputhje me atmosferën festive që dëshiron të krijojë. Dizajni duhet të jetë vizualisht tërheqës dhe festiv, veçanërisht gjatë natës. Dizajni duhet të përmbajë shkrimi “Ohoho”.

- **Kërkesë për dizenjime paraprake:** Përpara prodhimit, kërkohet paraqitja e disa dizenjimeve konceptuale që të pasqyrojnë ide të ndryshme të përpuethshme me natyrën e kopshtit zoologjik. Këto dizenjime do të diskutohen dhe dakordësohen me autoritetin kontraktor për të arritur një dakordësi mbi dizajnin përfundimtar përpara se të fillojë ndërtimi/prodhimi.
- **Pregatitja për prodhim:** Dizajnet e përshkruara më lart duhet të pregatiten për prodhim sipas nevojave apo kërkesave të AK-së.

Specifikimet dhe kërkesat teknike:

1. **Materiali:** Material Forex, akrilik, ose polesterol i qëndrueshëm ndaj kushteve të jashtme, me trashësi 15-25 cm për stabilitet.
2. **Përmasat:** Çdo shkronjë të ketë një lartësi afro 1.2 m dhe gjerësi proporcionale për të siguruar dukshmëri në ambiente të hapura.
3. **Ngjyrat dhe Dekorimet:** Shkronjat të jenë me ngjyrë të kuqe të ndezur, me elemente të kapeles së babagjyshit.
4. **Montimi:** Strukturë mbështetëse e fshehur për stabilizimin e shkronjave në tokë, rezistente ndaj erës dhe kushteve atmosferike.
5. **Vendosja:** Të pozicionohet në një zonë të gjelbëruar ose mes luleve për efekt vizual maksimal dhe për t'u përshtatur me ambientin përreth.

18. Kuti dhuratash të ndriçuara

Koncepti i dizajnit grafik dhe pregatitja për kutitë e dhuratave ndriçuese:

Përshkrimi i Konceptit të Dizajnit:

- **Tematika konceptuale:** Dizajni duhet të përshtatet me temën e eventit, që duhet të jetë festive. Dizenjatori duhet të zgjedhë ngjyrat dhe format e dritave në përputhje me atmosferën festive që dëshiron të krijojë. Dizajni duhet të jetë vizualisht tërheqës dhe festiv, veçanërisht gjatë natës. Dizajni duhet të përmbajë objekte 3D me ndriçim, që simbolizon kutitë e dhuratave të babagjyshit.
- **Kërkesë për dizenjime paraprake:** Përpara prodhimit, kërkohet paraqitja e disa dizenjimeve konceptuale që të pasqyrojnë ide të ndryshme të përpuethshme me natyrën e kopshtit zoologjik. Këto dizenjime do të diskutohen dhe dakordësohen me autoritetin kontraktor për të arritur një dakordësi mbi dizajnin përfundimtar përpara se të fillojë ndërtimi/prodhimi.
- **Pregatitja për prodhim:** Dizajnet e përshkruara më lart duhet të pregatiten për prodhim sipas nevojave apo kërkesave të AK-së.

Specifikimet dhe kërkesat teknike:

- **Përmasat:** Përafërsisht kuboida me dimensione 50 cm, 70 cm dhe 80 cm
- **Materiali:** Plexiglas, foreks ose materiale të tjera të veshur me motive festive (p.sh., motive bore dhe shirita të artë).
- **Dritat:** LED me ngjyra të ngrohta, furnizim me bateri ose prizë.
- **Ngjyra:** E kuqe me detaje të bardha dhe shirita të artë.

19. Instalacion “Dashuria ime”

Koncepti i Dizajnit grafik dhe përgatitja për prodhim e hapësirës së branduar, për këndin dekorativ “Dashuria ime”:

Përshkrimi i Konceptit të Dizajnit:

Tematika konceptuale: Ky dizajn do të sigurojë një pamje tërheqëse dhe romantike, duke e bërë instalacionin një zonë të përsosur për foto dhe një simbol të dashurisë në këtë ditë të veçantë. E gjithë struktura do të jetë e mbuluar me një shtresë të kuqe, të ndritshme ose mat, që të përcjellë ndjenjën e dashurisë dhe ngrohtësisë. Në qendër të instalacionit, do të vendoset një mesazh dashurie i shkruar me një font të bukur dhe elegant. Mesazhi do të ngjitet në pjesën e qendrës së podiumit ose mund të vendoset mbi një strukturë të vogël mbështetëse që e ngrit pak mbi zemrat, për ta bërë të lehtë për t'u lexuar nga çdo kënd. Të gjitha zemrat do të jenë të kuqe, por mund të përfshihen nuanca të ndryshme për t'i dhënë një efekt më të gjallë dhe të ndjeshëm. Në qendër një zemër e madhe, e cila do përmbajë një mesazh për ditën e të dashuruarve. Edhe zemrat e vogla mund të përmbajnë mesazhe dashurie për jetën dhe/ose partnerin/en.

Përgatitja për prodhim:

Dizajnet e përshkruara më lart duhet të përgatiten për prodhim sipas nevojave apo kërkesave të AK-së. **Gjatë përgatitjes së strukturës për prodhim të planifikohet** përdorimi i materialeve të lehta dhe të qëndrueshme, ekologjike, të mbuluara me veshje të papërshkueshme nga uji dhe të sigurta për përdorim në natyrë. Po ashtu të planifikohet edhe zbrërthimi i skicave teknike të cilat do të shërbejnë me vonë për ndërtimin e instalacionit. Dizenjatori duhet të ndjekë me përpikmëri procesin e prodhimit dhe të japë zgjidhje për çdo situatë problematike gjatë proceseve teknike.

Specifikimet dhe kërkesat teknike:

Konstruksioni:

- **Materiali Kryesor:** Strukturë metalike/dru e fortë për të siguruar qëndrueshmëri dhe stabilitet në ambiente të jashtme, me veshje dekorative PVC ose moket për të krijuar efektin e një podiumi dhe të japë ndjesinë e një ambjenti të ngrohtë shtëpize. Moketi duhet të jetë ngjyrë e kuqe për të simbolizuar ditën e të dashuruarve. Instalacioni duhet të jetë i lehtë për t'u montuar dhe çmontuar, duke e bërë të përshtatshëm për transport dhe ruajtje
- **Mbështetës dhe Stabilizues:** Baza metalike/dru për stabilitet dhe rezistencë ndaj erës dhe motit të keq.

- **Përmasat e podiumit: Afërsisht 200x200x10 cm, e veshur me moket ngjyrë të kuqe.**
- **Përmasat e zemrave:** Zemrat e prodhuara me material forex ose polisterol i përpunuar përshatshëm për përdorim të jashtëm, printim direkt mbi material. Në total janë 9 zemra: 1 zemër e madhe (rreth 100 cm e gjerë) dhe 8 zemra të vogla (nga 30 cm deri në 50 cm të gjera). Lartësi të ndryshme nga 30 cm deri në 1.2 metra për të krijuar një efekt me nivele.

20. Dekor me tullumbaca

Dekor me tullumbaca të varura për për festën e Shën Valentinit, të varura në trarët e ZOO-së. Përdorimi i tullumbacave latex në formë zemre, me madhësi të ndryshme afro 30 dhe 50 cm, të varura me fije najloni të tejdukshme. Të vendosen në lartësi të ndryshme për një efekt dinamik. Në hyrje të kopshtit zoologjik tek kollonat dhe përgjatë rrugës në brendësi, sipas dakordësisë edhe me autoritetin kontraktor.

21. Zemrat dekorative

Koncepti i Dizajnit grafik dhe përgatitja për prodhim e zemrave dekorative

Përshkrimi i Konceptit të Dizajnit:

Tematika konceptuale: Ky dizajn do të sigurojë një pamje tërheqëse dhe romantike, duke e bërë instalacionin një zonë të përsosur për foto dhe një simbol të dashurisë në këtë ditë të veçantë. Zemrat do përmbajnë mesazhe dashuri të printuara në trup dhe do të ngulen në pjesën e lulishtes para hyrjes së kopshtit Zoologjik. Format e tyre në formë zemre do jenë të kapura në trup me një shkop, i cili do ketë lartësi të ndryshme për të dhënë fushatës një ndjesi unike dhe të veçantë. E gjithë lulishtja do të jetë e mbuluar me zemra të kuqe, të ndritshme ose mat, që të përcjellë ndjenjën e dashurisë dhe ngrohtësisë.

Përgatitja për prodhim:

Dizajnet e përshkruara më lart duhet të përgatiten për prodhim sipas nevojave apo kërkesave të AK-së. **Gjatë përgatitjes së strukturës për prodhim të planifikohet** përdorimi i materialeve të lehta dhe të qëndrueshme, ekologjike, të mbuluara me veshje të papërshkueshme nga uji dhe të sigurta për përdorim në natyrë. Po ashtu të planifikohet edhe zbrëthimi i skicave teknike të cilat do të shërbejnë me vonë për ndërtimin e instalacionit. Dizenjatori duhet të ndjekë me përpikmëri procesin e prodhimit dhe të japë zgjidhje për çdo situatë problematike gjatë proceseve teknike.

Specifikimet dhe kërkesat teknike:

- **Materiali Kryesor:** PVC, Forex, akrilik ose material i lehtë me spesor 5mm e printuar direkt mbi trup.
- **Stabilizuesi:** Shkop metalike/PVC për stabilitet dhe rezistencë ndaj agjentëve atmosferikë.
- **Përmasat:** Ato duhet të kenë madhësi nga **30 cm deri në 50 cm**. Zemrat do të ngulen në tokë duke përdorur shkopinj metalikë ose plastikë të qëndrueshëm, me lartësi të dukshme prej 50 cm deri në 70cm.

Të gjitha komponentët do të jenë të rezistueshëm ndaj diellit, shiut dhe erës, duke siguruar një dekor të qëndrueshëm dhe estetik për ambientin e jashtëm.

22. Instalacion “Dita e flamurit”

Koncepti i Dizajnit grafik dhe përgatitja për prodhim e hapësirës së branduar akomoduese, dekorative për Festat e Flamurit:

Përshkrimi i Konceptit të Dizajnit:

Tematika konceptuale: Instalacioni duhet të përfaqësojë një zone hyrjeje të gëzueshme dhe të ndritshme të ZOO-së, e cila përcjell ngrohtësi, festim dhe magjinë e festës së flamurit. Dizajni duhet të jetë miqësor për fëmijët dhe të ftojë vizitorët në këtë ambient mikpritës.

Elementët Vizualë të strukturës: Stil i frymëzuar nga elementët e flamurit, shqiponjës dhe ngjyrave kuq e zi. Format do të jenë vizualisht unike dhe të veçanta. Instalacioni do të mund të shoqërohet edhe me elementë dekorativ të tjerë që përfaqësojnë sërish elementët e flamurit, për të krijuar një efekt të shkëlqyer dhe tërheqës.

Përgatitja për prodhim:

Dizajnet e përshkruara më lart duhet të përgatiten për prodhim sipas nevojave apo kërkesave të AK-së dhe departamentit përkatës të prodhimit. **Gjatë përgatitjes së strukturës për prodhim të planifikohet** përdorimi i materialeve të lehta dhe të qëndrueshme, ekologjike, të mbuluara me veshje të papërshkueshme nga uji dhe të sigurta për përdorim në natyrë. Po ashtu të planifikohet edhe zbërthimi i skicave teknike të cilat do të shërbejnë me vonë për ndërtimin e instalacionit. Dizenjatori duhet të ndjekë me përpikmëri procesin e prodhimit dhe të japë zgjidhje për çdo situatë problematike gjatë proceseve teknike

Specifikimet dhe kërkesat teknike:

- **Lartësia:** Porta dekorative do të jetë rreth 3.5 metra e lartë, duke krijuar një hyrje të dukshme dhe tërheqëse që tërheq vizitorët nga distanca.
- **Gjerësia:** Për të mbajtur një proporcion estetik, forma do të ketë gjithashtu gjerësi rreth 3 metra. Kjo formë do të formojë një hapësirë qendrore të hapur për kalimin e vizitorëve.
- **Struktura kryesore:** Materiali kryesor i përdorur për ndërtimin e rrethit të jetë **hekuri, alumini**, ose material rezistent ndaj agjentëve atmosferike. Kjo strukturë do të ketë veshje foreks, dru ose materiale rezistente dhe të lehta në peshë me trashësi 5-10 mm, e cila do të sigurojë qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi në kushte të ndryshme atmosferike.
- **Siguria dhe Stabiliteti:** Struktura do të ketë një bazë të fortë dhe të qëndrueshme, me përforcime për t'i rezistuar erërave të forta dhe ndryshimeve klimaterike, duke siguruar sigurinë e vizitorëve.
- **Vendosja:** Forma do të vendoset në qendër të hyrjes, duke shërbyer si pika kryesore për fotografi dhe atraksion për vizitorët.

23. Kënde mikpritëse

Gjatë këtyre ditëve do të realizohen kënde me kashtë për vizitorët të dekoruara me mbulesa kuq e zi. Këto mbulesa të kenë motive tradicionale shqiptare, si simbole folklorike, për të reflektuar kulturën tonë. Këndet do të jenë të organizuara në formë stoli dhe tavolinash, duke ofruar komoditet për grupe të vogla vizitorësh. Mbulesat do të jenë prej tekstili dhe do kenë afërsisht përmasat 80-120 cm.

24. Dekorim pemësh

Gjatë ditëve të festave të flamurit do të kërkohet dekorimi i trungjeve të pemëve me shirita kuq e zi për Ditën e Flamurit. Shirita duhet të jenë prej materiali rezistent ndaj kushteve atmosferike, si pëlthurë najloni ose poliesteri, me gjerësi 10 cm dhe gjatësi të mjaftueshme për të mbuluar trungun e pemës deri në tokë, me gjatësi 2.5-3 metra, duke krijuar një efekt vertikal dhe tërheqës. Ngjyrat duhet të alternohen kuq e zi për të pasqyruar ngjyrat e flamurit shqiptar dhe për të krijuar një kontrast të fortë vizual. Për çdo pemë, rekomandohet përdorimi i disa shiritave për të mbuluar plotësisht trungun dhe për të krijuar një efekt të dukshëm festiv deri në bazën e pemës.

25. Dekorim trarësh

Gjatë ditëve të festave të flamurit do të kërkohet dekorimi i kolonave të trarit në hyrje të kopshtit zoologjik me shirita kuq e zi në simbolikë të Ditës së Flamurit. Shirita duhet të jenë prej materiali rezistent ndaj kushteve atmosferike, si tekstil, pëlthurë najloni ose poliesteri, me gjerësi 10-20 cm dhe gjatësi të mjaftueshme për të krijuar një efekt vizual tërheqës. Ngjyrat duhet të alternohen me shirita kuq e zi për të pasqyruar ngjyrat e flamurit shqiptar dhe për të krijuar një kontrast të fortë vizual dhe të paharrueshëm, në kujtim të dëshmorëve dhe simbolit tonë kombtar.

26. Dekor me tullumbace

Gjatë ditëve të festave të flamurit do të realizohet dekori me 500 tullumbaca në ngjyra të kuqe dhe të zezë për t'u vendosur përgjatë rrugës në kopshtin zoologjik dhe në pjesën e trarëve të drurit në pjesën e hyrjes. Tullumbaca latex në madhësi 30cm-50cm, të pajisura me shkopinje të hollë plastik për t'u ngulur në tokë, ose të varur në lartësi. Tullumbacët duhet të alternohen në ngjyrat e kuqe dhe të zezë dhe të vendosen në radhë të rregullt përgjatë rrugës për të krijuar një efekt të bukur vizual dhe tërheqës për vizitorët.

27. Dekor me flamuj kuq e zi

Dekor me flamuj shqiptarë për t'u vendosur midis pemëve në kopshtin zoologjik. Flamujt duhet të jenë me dimensione afro 100x150 cm dhe të varur nga një pemë në tjetrën me spango transparente. Materiali i flamujve duhet të jetë tekstil dhe të jetë i lehtë dhe qëndrueshëm ndaj kushteve të jashtme, si era dhe lagështia.

28. Instalacion “lulja e verës”

Koncepti i Dizajnit grafik dhe përgatitja për prodhim e hapësirës së branduar akomoduese, dekorative për ditën e verës:

Përshkrimi i Konceptit të Dizajnit:

Tematika konceptuale: Instalacioni duhet të përfaqësojë një zonë hyrje të gëzueshme dhe të ndritshme të ZOO-së, e cila përcjell ngrohtësi, festim dhe magjinë e festës së ditës së verës. Dizajni duhet të jetë miqësor për fëmijët dhe të ftojë vizitorët në këtë ambient mikpritës.

Elementët Vizualë të strukturës: Stil i frymëzuar nga elementët e stinës së verës, si luledielli, dielli etj. Format do të jenë vizualisht unike dhe të veçanta. Instalacioni do të mund të shoqërohet edhe me elementë dekorativ të tjerë që përfaqësojnë serish elementët e kësaj dite, për të krijuar një efekt të shkëlqyer dhe tërheqës.

Përgatitja për prodhim:

Dizajnet e përshkruara më lart duhet të përgatiten për prodhim sipas nevojave apo kërkesave të AK-së dhe departamentit përkatës të prodhimit. **Gjatë përgatitjes së strukturës për prodhim të planifikohet** përdorimi i materialeve të lehta dhe të qëndrueshme, ekologjike, të mbuluara me veshje të papërshkueshme nga uji dhe të sigurt për përdorim në natyrë. Po ashtu të planifikohet edhe zberthimi i skicave teknike të cilat do të shërbejnë me vonë për ndërtimin e instalacionit. Dizenjatori duhet të ndjekë me përpikmëri procesin e prodhimit dhe të jap zgjidhje për çdo situatë problematike gjatë proceseve teknike.

Specifikimet dhe kërkesat teknike:

- **Lartësia:** Porta dekorative do të jetë rreth 3.5 metra e lartë, duke krijuar një hyrje të dukshme dhe tërheqëse që tërheq vizitorët nga distanca.
- **Gjerësia:** Për të mbajtur një proporcion estetik, forma do të ketë gjithashtu gjerësi rreth 3 metra. Kjo formë do të formojë një hapësirë qendrore të hapur për kalimin e vizitorëve.
- **Struktura kryesore:** Materiali kryesor i përdorur për ndërtimin e rrethit të jetë **hekuri, alumini**, ose material rezistent ndaj agjentëve atmosferike. Kjo strukturë do të ketë veshje foreks, dru ose materiale rezistente dhe të lehta në peshë me trashësi 5-10 mm, e cila do të sigurojë qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi në kushte të ndryshme atmosferike.
- **Siguria dhe Stabiliteti:** Struktura do të ketë një bazë të fortë dhe të qëndrueshme, me përforsime për t'i rezistuar erërave të forta dhe ndryshimeve klimaterike, duke siguruar sigurinë e vizitorëve.
- **Vendosja:** Forma do të vendoset në qendër të hyrjes, duke shërbyer si pika kryesore për fotografi dhe atraksion për vizitorët.

29. Biçikleta Luledielli

Kërkesa grafike dhe prodhimi

Dekor në hyrje të Kopshtit Zoologjik, një biçikletë të lyer në ngjyrë të verdhë, e cila është e pajisur me një kosh plot me lulediell, për të krijuar një atmosferë të ngrohtë dhe festive për Ditën e Verës. Biçikleta duhet të jetë e lyer sipas idese dhe konceptit të kësaj dite (ngjyra e verdhë është e preferueshme). E verdha dhe e gjelbër janë ngjyrat kryesore, të cilat duhet të jenë të ndritshme dhe të ngrohta për të përcjellë një ndjesi gëzimi dhe freskie. Shporta mund të personalizohet me një mesazh ose dekor shtesë, si një fjongo e kuqe ose një emërtim që lidhet me vendndodhjen ose ngjarjen ku do të përdoret instalacioni. Vendorsja e disa bimëve ose elementeve të tjera natyrore rreth bazës së instalacionit për të krijuar një ambient më të gjallë dhe realist. Biçikleta duhet të jetë e bërë nga metal, për të siguruar stabilitet dhe jetëgjatësi, veçanërisht në mjedise të jashtme. Ngjyra e biçikletës do të jetë e verdhë për t'u harmonizuar me lulet, duke krijuar një pamje të ndritshme dhe tërheqëse. Biçikleta nuk duhet të jetë funksionale për çiklizëm, duhet të jetë e ngulitur në një vend të caktuar për të shërbyer si dekor i qëndrueshëm. Biçikleta duhet të jetë e ancoruar në mënyrë të sigurtë në bazament për të siguruar qëndrueshmëri dhe siguri, duke përdorur vida ose struktura të fshehta mbështetëse dhe do jetë e pozicionuar në një vend shumë të dukshëm në lulishten e parkut të ZOO-së.

30. Kënd Luledielli

Kërkesa për Dizajnin Grafik

Dizajni duhet të përmbajë luledielli të mëdhenj dhe të vegjël, të vizatuar me detaje të sakta të petaleve dhe gjetheve për të dhënë një efekt realist dhe tërheqës. Ngjyra e verdhë e ndritshme për petalet dhe e gjelbër për gjethet. Ngjyrat duhet të jenë të ngrohta dhe të qëndrueshme ndaj dritës, duke krijuar një efekt të gjallë që tërheq vëmendjen e vizitorëve të parkut. Një vrimë/zonë e hapur në qendër të lulediellit më të madh, i dizajnuar për t'u përdorur si kornizë për foto dhe ku vizitorët mund të fusin lehtësisht kokën. Konturi i rrethit duhet të jetë i fortë dhe i dallueshëm, me një ngjyrë që kontraston, por gjithashtu harmonizohet me pjesën tjetër të instalacionit. Vizualet duhet të jenë të përshtatura për printim me cilësi të lartë ose për lyerje artizanale, bazuar në mënyrën e prodhimit të përzgjedhur.

Kërkesa për prodhimin

Materiali i Strukturës: Materialet duhet të jenë të lehta (forex, PVC etj) dhe të printueshme, por të qëndrueshme dhe rezistente ndaj kushteve atmosferikë dhe i lehtë për t'u montuar. Këto materiale do të sigurojnë që instalacioni të qëndrojë në formë dhe ngjyrë për një kohë të gjatë.

Qëndrueshmëria: Konstruksioni i instalacionit duhet të jetë i qëndrueshëm dhe të ketë një strukturë të brendshme prej metali që të mbështesë peshën e të gjithë elementeve. Duhet të ketë stabilitet të mirë për të mos u rrëzuar nga era apo ndonjë lëvizje e papritur

Printimi/prodhimi: Te jetë me ngjyra të plota, me cilësi shumë të lartë, me bojra ekologjike dhe bojra të gjalla(vivid colors.)

Përmasat: Dimensionet e afërta për realizimin e këtij instalacioni janë: 200-280 cm dhe trashësia të jetë 1-3 cm.

31. Luledielli dekor

Kërkesa për Dizajnin Grafik:

- **Forma e Lulediellit:** Duhet të përmbajë petale të ndritshme, të verdha dhe të detajuara për të krijuar një efekt realist dhe të ngrohtë. Petalet janë të shpërndara në mënyrë rrethore rreth qendrës së lulediellit.
- **Qendra e Lulediellit:** Dizajni grafik duhet të përfshijë një teksturë të detajuar dhe të ndërlikuar për qendrën e lulediellit, duke e bërë të duket e thellë dhe natyrale.
- **Mundësisht ndonjë nusepashke në dizajn:** Elementi i nusepashkës duhet të jetë i theksuar me ngjyrat e kuqe dhe të zezë për të krijuar një kontrast të këndshëm dhe tërheqës. Ai duhet të jetë i pozicionuar në mënyrë të qartë dhe të duket i gjallë.
- Ngjyrat duhet të jenë të ndritshme dhe të qëndrueshme për t'i dhënë lulediellit një pamje natyrale dhe të freskët. Përbërësit kryesorë do të jenë e verdha, e gjelbra për gjethet dhe e kuja për nusepashkën.

Kërkesa për prodhimin

- **Materiali i Strukturës së Lulediellit:** Materiali duhet të jetë i qëndrueshëm dhe rezistent ndaj kushteve të jashtme, si materiale të ngjashme të lehta dhe të qëndrueshme. Këto materiale janë të përshtatshme për prodhimin e detajeve të sakta. Duhet të përdoren materiale që lejojnë formësimin dhe ngjyrosjen me detaje të sakta, për t'i dhënë dizajnit një pamje realiste.
- **Qëndrueshmëria:** Luledielli duhet të jetë i qëndrueshëm dhe të ketë një strukturë të brendshme që të mbështesë peshën e të gjithë elementeve nëse do ketë. Duhet të ketë material i lehtë dhe rezistent ndaj kushteve atmosferikë për të mos u rrëzuar nga era apo ndonjë lëvizje e papritur. Luledielli do varet nga njëra pemë në tjetrën me fill të tejdukshëm.
- **Printimi/prodhimi:** Te jetë me ngjyra të plota, me cilësi shumë të lartë, me bojra ekologjike dhe bojra të gjalla(vivid colors.)
- **Përmasat:** Dimensionet e afërta për realizimin e këtij luledielli janë: 50-120 cm dhe trashësia të jetë jo më shumë 1 cm.

32. Byzylyk plastikë

Kërkesa për Dizajnin Grafik:

- Dizajni grafik duhet të përmbajë silueta kafshësh/shpendësh, logon e ZOO-së dhe/ose elementë të tjerë të kërkuar nga AK. Ngjyrat e duhet të jenë të ndritshme, për të krijuar një ndjesi të ngrohtë. Elementët duhet të jenë të theksuara me ngjyrat e ZOO-së për të krijuar një kontrast të këndshëm dhe tërheqës.

Kërkesa për prodhimin

- **Materiali i Strukturës së Lulediellit:** Materiali duhet të jetë ekologjik, rezistent ndaj kushteve të jashtme, të lehta dhe me ngjyra të ndryshme
- **Printimi/prodhimi:** Të jetë me ngjyra të plota, me cilësi shumë të lartë, me bojra ekologjike dhe bojra të gjalla (vivid colors.)
- **Përmasat:** Dimensionet e përafërta janë: 5-8 cm diametri.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Nr.	Përshrimi i produktit	Njësia	Sasia e pritshme	Afati i lëvrimit
1	Pema e Krishtlindjeve	copë	1	12 muaj nga nënshkrimi i MK
2	Shtëpia e Babagjyshit	copë	1	12 muaj nga nënshkrimi i MK
3	Drita dekorative	copë	1,000	12 muaj nga nënshkrimi i MK
4	Drita për pemë	copë	4	12 muaj nga nënshkrimi i MK
5	Korridor dekorativ	copë	1	12 muaj nga nënshkrimi i MK
6	Instalacion dekorativ në hyrje	copë	1	12 muaj nga nënshkrimi i MK
7	Silueta kafshësh/shpendësh me ndriçim led, në trarët e ZOO-së	copë	6	12 muaj nga nënshkrimi i MK
8	Silueta kafshësh/shpendësh me ndriçim led, në liqenin e ZOO-së	copë	6	12 muaj nga nënshkrimi i MK
9	Silueta kafshësh/shpendësh, në parkun e ZOO-së	copë	20	12 muaj nga nënshkrimi i MK
10	Flutura ndriçuese	copë	10	12 muaj nga nënshkrimi i MK
11	Dekor plaku i dëborës	copë	2	12 muaj nga nënshkrimi i MK
12	Zona festive e fermës	copë	1	12 muaj nga nënshkrimi i MK
13	Projektori magjik	copë	2	12 muaj nga nënshkrimi i MK
14	Dekor krahë palloi me ndriçim	copë	1	12 muaj nga nënshkrimi i MK
15	Strukturë ndriçuese për foto	copë	1	12 muaj nga nënshkrimi i MK
16	Strukturë me gërma 3D "ZOO"	copë	1	12 muaj nga nënshkrimi i MK

17	Shkrim i stilizuar “OHOHO”	copë	1	12 muaj nga nënshkrimi i MK
18	Kuti dhuratash të ndriçuara	copë	10	12 muaj nga nënshkrimi i MK
19	Instalacion “Dashuria ime”	copë	1	12 muaj nga nënshkrimi i MK
20	Dekor me tullumbaca	copë	500	12 muaj nga nënshkrimi i MK
21	Zemrat decorative	copë	100	12 muaj nga nënshkrimi i MK
22	Instalacion “Dita e flamurit”	copë	1	12 muaj nga nënshkrimi i MK
23	Kënde mikpritëse	copë	10	12 muaj nga nënshkrimi i MK
24	Dekorim pemësh	copë	1	12 muaj nga nënshkrimi i MK
25	Dekorim trarësh	copë	1	12 muaj nga nënshkrimi i MK
26	Dekor me tollumbace	copë	500	12 muaj nga nënshkrimi i MK
27	Dekor me flamuj kuq e zi	copë	100	12 muaj nga nënshkrimi i MK
28	Instalacion “lulja e verës”	copë	1	12 muaj nga nënshkrimi i MK
29	Biçikleta Luledielli	copë	1	12 muaj nga nënshkrimi i MK
30	Kënd Luledielli	copë	1	12 muaj nga nënshkrimi i MK
31	Luledielli dekor	copë	300	12 muaj nga nënshkrimi i MK
32	Byzylyk plastikë	copë	500	12 muaj nga nënshkrimi i MK

Afati i MK: 12 (dymbëdhjetë) muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Afatet e lëvrimit të minikontratave: 10 (dhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratave, dhe brenda afatit 12 (dymbëdhjetë) mujor të Marrëveshjes Kuadër.

Vendi i lëvrimit të mallrave: Kopshti Zoologjik i Tiranës, me adresë Rruga “Liqeni i Thatë”, Tiranë, Shqipëri

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

c. *Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1;*

ç. *Lista e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet financiare (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë, fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2. Operatori ekonomik për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave duhet të ketë të punësuar minimalisht 4 (katër) punonjës, vërtetuar me listëpagesën e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave;

***Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar ose me kontratë angazhimi / bashkëpunimi punonjësit e mëposhtëm:

- 2 (dy) specialistë dizenjator grafik;
- 1 (një) punonjës saldator;
- 1 (një) punonjës elektrikist;

Për punonjësit e mësipërm, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Diplomë ose certifikatë e lëshuar nga organizma të akredituar në Republikën e Shqipërisë;
- Kontratë individuale të punës ose shërbimit të vlefshme për të gjithë kohëzgjatjen e kësaj kontrate;
- Listëpagesa e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave për punonjësit e punësuar nga operatori ekonomik;

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. **Të plotësohet formulari përmbledhës i vetëdeklarimit me të dhënat e detajuara (emër, mbiemër, detyra që do të realizojë, diplomë ose certifikatë, numri, data e lëshimit, institucioni që e ka lëshuar).**

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3.4. Operatori ekonomik për transportin e mallrave duhet të provojë se disponon në pronësi ose me qera 1 (një) automjet me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton.

- Për mjetin duhet të paraqitet çertifikatë pronësie ose kontrate qeraje e lidhur tek noteri, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi;
- Leje qarkullimi;
- Çertifikatën e kontrollit teknik;
- Siguracionin e mjetit;

Mjetet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar (shitblerje ose kontrata dhurimi).

Mjetet me qira shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qirasë të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi).

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. **Të plotësohet formulari përmbledhës i vetëdeklarimit me të dhënat e mjetit, targa, pronësi / qira.** Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3.5. Operatori ekonomik për realizimin e produkteve të kërkuara duhet të provojë se disponon në pronësi ose me qera pajisjet e mëposhtëme:

- 1 (një) makineri ploter me bojra UV;
- 1 (një) makineri për prerje me forma;
- 1 (një) makineri ploter për material adeziv/tekstil;

Pajisjet mund ti ketë në pronësi (vërtetuar me fatura blerje / akte zhdoganimi / pasqyrim në bilanc) ose me qira (vërtetuar me kontratë qiraje).

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. ***Të plotësohet formulari përmbledhës i vetëdeklarimit me të dhënat e pajisjeve, pronësi / qira, numri i faturave dhe data, nëse në bilanc faqa ku ndodhen.***

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se jep garanci për funksionimin normal të elementëve të dekorit gjatë periudhave festive në të cilat do të përdoren.

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër montimin e elementëve të dekorit gjatë periudhave festive në të cilat do të përdoren si dhe çmontimin e tyre në përfundim të festave dhe sistemimin e tyre me stafin e AK pranë magazinës së institucionit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
 _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

